



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3026/5 prot.

Datë 15.12.2025

V E N D I M
Nr. 1850/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.12.2025, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “ISEC” shpk & “ERGI” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrojtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “ARDMIR” shpk & “METEO” shpk në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “DEHA 2010” shpk & “ViaNex” shpk në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ISEC” SHPK me NIPT L41309004L dhe adresë Rruga Kodra e Diellit, Apartamenti 27, Shkalla 2, Kati 5, Tiranë

BOE “ARDMIR” shpk me NIPT K82509006P & “METEO” shpk me NIPT L26310801C dhe adresë Lagjia Konizbalte”, rruga kryesore Berat

BOE “DEHA 2010” shpk me NIPT L03425410B & “ViaNex” shpk me NIPT K87921701H dhe adresë Fshati Vajkan, zona kadastrale nr--3695 numer pasurie nr- 154/4, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mallakastër me adresë Lagjia “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08-09-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrojtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

II.2. Në datën 23-09-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 22.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Sterkaj” SHPK	43,000,000 lekë	skualifikuar
2. “Deha 2010” SHPK & “ViaNex” shpk	46,032,000 lekë	skualifikuar
3. “Isec” SHPK & “Ergi” shpk	48,036,430 lekë	skualifikuar
4. “Ardmir” SHPK & “Meteo” shpk	52,483,400 lekë	skualifikuar
5. “Shendelli” shpk	52,866,000 lekë	skualifikuar
6. “Fiam A” shpk	pa ofertë ekonomike	

II.4. Në datën 23.10.2025, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Anullimit të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 24.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3026/2025 protokoli, datë 27.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6010 e operatorit ekonomik “ISEC” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrojtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “ISEC” shpk & “ERGI” shpk.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3026/1 prot., datë 27.10.2025.

II.6. Në datën 28.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3053/2025 protokoli, datë 28.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6015 e BOE “ARDMIR” SHPK & “METEO” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrotje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “ARDMIR” shpk & “METEO” shpk.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3053/1 prot., datë 29.10.2025.

II.7 Në datën 28.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3067/2025 protokoli, datë 29.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6017 e BOE “DEHA 2010” SHPK & “ViaNex” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrotje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “DEHA 2010” SHPK & “ViaNex” SHPK.

II.7.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3067/1 prot., datë 29.10.2025.

II.8. Me shkresën me nr. 4086/20 prot., datë 31.10.2025, me lëndë “Vendimmarrje për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ISEC” SH.P.K”, protokolluar me tonën me nr. 3026/2 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “ISEC” shpk dhe “Ergi” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.9. Me shkresën me nr. 4086/21 prot., datë 31.10.2025, me lëndë “Vendimmarrje për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Ardmir” SH.P.K dhe “Meteo” shpk, protokolluar me tonën me nr. 3053/2 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “Ardmir” SH.P.K dhe “Meteo” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.10. Me shkresën me nr. 4086/22 prot., datë 31.10.2025, me lëndë “Vendimmarrje për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Deha 2010” SH.P.K dhe “ViaNex” shpk, protokolluar me tonën me nr. 3067/2 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “Deha 2010” SH.P.K dhe “ViaNex” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.11. Me shkresën me nr. 3053/3 prot., datë 03.12.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor Bashkisë Mallakastër si vijon: “[...] Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së dorëzuar nga BOE “ARDMIR” SHPK & “METEO” SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit nuk ka paraqitur formularin e ankesës sipas shtojcës “Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, të dokumentave standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik. Referuar nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjvënësi i ka dhënë operatorit ekonomik mundësinë procedurale të korrigjimit të të metave nëse formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, brenda dy ditëve nga njoftimi i autoritetit kontraktor. Referuar bazës ligjore të sipërcituar është autoriteti kontraktor i cili duhet të kryejë veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës. Sa më sipër, e qëllim vijimin e gjykimit të ankesës kërkojmë nga ana juaj informacion nëse keni kryer veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës”.

II.12. Me shkresën me nr. 4086/24 prot., datë 05.12.2025, me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj me nr. 3053/3, datë 03.12.2025 “Kërkesë për informacion”, protokolluar me tonën me nr. 3053/4 prot., datë 09.12.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “[...] Nga shqyrtimi i ankesës nga ana jonë nuk është konstatuar që operatori ekonomik nuk e ka paraqitur ankesën sipas shtojcës “Formulari i ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, pasi ankesa e kryer nga operatori ekonomik përmbushte të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me cështjen objekt ankimi (palët/objekti i ankimit/rrethanat e ankimit/shkaqet e ankimit/si dhe kryerja e pagesës së vlerës së përcaktuar). Përsa më sipër nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës është vijuar me trajtimin e ankesës në bazë të dokumentacionit të paraqitur në sistem nga BOE “Ardmir” shpk dhe “Meteo” shpk dhe ngarkimin e vendimit në sistemin elektronik të ankesave. Theksojmë se në procedurat në vijim, nga ana institucionit tonë do të mbahet në

konsideratë paraqitja e ankesës nga ana e OE sipas “Formulari i ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik” dhe plotësimi i tij sipas përcaktimeve ligjore”.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “ISEC” shpk & “ERGI” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ISEC” shpk & “ERGI” shpk konform nenit 83 Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe kriterëve të përcaktuara në DST ka përmbushur të gjitha kërkesat lidhur me sigurimin e ofertës. Konkretisht në ofertën e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ISEC” shpk & “ERGI”, shpk është ngarkuar Formulari i Sigurimit të Ofertës Nr. 2506006389, me vlerë 1,104,285.68 me afat vlefshmërie 150 ditë për procedurën objekt: “Mbrotje lumore gjatesore e Tokave Bujqesore ne fshatin Corrush, Mallakaster”, me numër REF-60311-09-04-2025, fond limit 55,214,284 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH me Autoritet Kontraktor Bashkia Mallakaster. Pavarësisht se garancia e ofertës (polica e sigurimit) është lëshuar vetëm në emër të “ISEC” shpk, duke qenë se ky subjekt është pjesë përbërëse e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “ISEC” sh.p.k. & “ERGI” sh.p.k., instrumenti konsiderohet ligjërish i vlefshëm për të gjithë bashkimin”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.b të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.1.2. Në shtojcën 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 3.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;*
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;*
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.*

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.1.3. Në Seksionin 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, “Njoftimi i kontratës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **1,104.285,68** (njemilion e njeqind e katërmije e dyqind e tetëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e tete) leke.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ shuma,monedha

Loti 2 _____ shuma, monedha

3.1.2 Autoriteti/ Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor me të dhëna: Dega e Thesarit Mallakastër 0924, Bashkia Mallakastër 2131001, Kodi Ekonomik 4662102 “Garanci bankare të vitit në vazhdim për sigurimin e ofertës” (në çdo bankë të nivelit të dytë).

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njqind e pesedhjetë) dite

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues “Isec” SHPK dhe “Ergi” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin e Sigurimit të Ofertës me Nr. Serial: 2506006389 lëshuar në emër të shoqërisë “Isec” SHPK, të lëshuar më datë 23.09.2025, nga shoqëria e sigurimeve “Albsig” SHA për Bashkinë Mallakastër, për procedurën e prokurimit me objekt: “Mbrotje lumore gjatësore e tokave bujqësore në fshatin Corrush, mallakastër.”, me REF-60311-09-04-2025, me përmbajtje si vijon: Ne vërtetojmë se: ISEC L41309004L

është garantuar pranë ALBSIG SHA me një vlerë prej lek 1.104.285,68 (një milion e njëqind e katër mijë e dyqindë e tetëdhjetë e pesë, gjashtëdhjetë e tetë) si kusht për sigurimin e ofertës dorëzuar nga operatori i lartëpërmendur ekonomik. Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në (njoftimin e kontratës ose ftesën për tender): 150 ditë.

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e*

kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor.

Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”.

III.1.7. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”.*

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, të Njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, ku njëra është në formën e garancisë bankare ose tjetra nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente, sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej **1,104.285,68** (*njemilion e njeqind e katermije e dyqind e tetedhjetë e pese presje gjashtedhjetë e tete*) leke, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 150 ditë.

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.10 Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues me arsyetimin se: *“BOE “ISEC” SHPK & “ERGI” SHPK me NUIS L41309004L & K02727229P skualifikohet pasi nuk përmbush pikën 2 kriteret të vecanta të kualifikimit kpnkretisht pikën 1. shkronjën a për sigurimin e ofertës pasi sigurimi i ofertës është bërë në emrin e një subjekti ,ku sipas ligjit sigurimi duhet të behet në emrin e bashkimit të operatorve”, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga BOE ankimues, Komisioni konstaton se ky i fundit ka dorëzuar Formularin e Sigurimit të Ofertës, me Nr. Serial: 2506006389 lëshuar në emër të shoqërisë “Isec” SHPK, të lëshuar më datë 23.09.2025, nga shoqëria e sigurimeve “Albsig” SHA për Bashkinë Mallakastër, për procedurën e prokurimit me objekt: “Mbrotjtje lumore gjatësore e tokave bujqësore në fshatin Corrush, mallakastër.”, me REF-60311-09-04-2025, me përmbajtje si vijon: “Ne vërtetojmë se: ISEC L41309004L është garantuar pranë ALBSIG SHA me një vlerë prej lek 1.104.285,68 (njëmilion e njëqind e katër mijë e dyqindë e tetëdhjetë e pesë, gjashtëdhjetë e tetë) si kusht për sigurimin e ofertës dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik. Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në (njoftimin e kontratës ose ftesën për tender): 150 ditë.*

Nga verifikimi i sigurimit të ofertës të dorëzuar në SPE Komisioni konstaton se ky i fundit është lëshuar në njërën prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga shoqëri të licencuara nga autoritetet kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “Albsig” SHA, ky formular është sipas vlerës dhe afatit të vlefshmërisë së kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” të dokumenteve të tenderit, por nuk është lëshuar në emër të BOE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Referuar pikës 2 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: ***“2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë, si dhe nga verifikimi i Formularit sigurimit të ofertës Komisioni konstaton se, BOE ankimues në Formularin e sigurimit të ofertës të dorëzuar në SPE nuk ka specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.***

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomik “Isec” SHPK dhe “Ergi” shpk me dokumentacionin e dorëzuar nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b të Shtojcës 7/2 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “DEHA 2010” shpk & “ViaNex” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“KONTRATAT TE NGJASHME “DEHA 2010” sh.p.k “Germim dhe Mbushje per ndertimin e infrastruktures se perbashket ne objektin Green Coast 2” me vlere te realizuar: 92,742,681.67 Leke pa tvsh; “Germim, Sistemim dhe Transport mbeturina inerte me auto te gjeneruara nga ndertimi ne vende te autorizuar deri 7.5 km, Perroi te Ura GCI, Palase” me vlere te realizuar: 2,306,910.77 Leke pa tvsh; “Germim mbushje i linjave KUSH dhe KUN per Infrastrukturen rrugore ne objektin Mgallery Hotel, projekti Green Coast” me vlere te realizuar: 3,855,583.72 Leke pa tvsh; “Germim dhe Transport materiali te dale nga germimi deri ne nje distance 7 km ne Vilat 20-21-22-23-24-25-26-27-28 Zona G11 Green Coast 2, Palase” me vlere te realizuar: 166,634.74 Euro pa tvsh; “Mbushje me material te selektuar nga germimi Parkimi L, ne kantierin Green Coast 2, Palase” me vlere te realizuar: 8,050,683.23 Leke pa tvsh; “Mbushje strukturale, Palase” me vlere te realizuar: 5,049,670.34 Leke pa tvsh; “Punime infrastrukture ne rrugen hyrese te viles 195, GCI, Palase” me vlere te realizuar: 3,957,364.88 Leke pa tvsh; “Sistemim Asfaltim rruget e drejtorise se rajonit jugor Gjirokaster” me vlere te realizuar nga DEHA 2010: 46,666,205.60 Leke pa tvsh; “EPCPA01246 Ndertimi i rruges se aksesit dhe riveshje me asfaltobeton e rruges nga fshati Libofshe ne fshatin Agim, Fier” me vlere te realizuar: 320,196.20 Euro pa tvsh Bazuar ne preventivin e punimeve, i cili ne thelb ka vetem punime germimi dhe mbushje. Referuar puneve te ngjashme te paraqitura nga DEHA 2010 shpk rezulton se i permbush 100% punimet per:*

- 1. Mbushje me zhavorr lumi per rruge aksesit Referuar kontrates;*
- a. Sistemim Asfaltim rruget e drejtorise se rajonit jugor Gjirokaster;*
- 2. Transport dheu me auto deri ne 5.0 km Referuar kontrates;*
- a. Sistemim Asfaltim rruget e drejtorise se rajonit jugor Gjirokaster;*
- b. Germim dhe Mbushje per ndertimin e infrastruktures se perbashket ne objektin Green Coast 2;*
- c. Germim dhe Transport materiali te dale nga germimi deri ne nje distance 7 km ne Vilat 20-21-22-23-24-25-26-27-28 Zona G11 Green Coast 2, Palase*
- d. Germim, Sistemim dhe Transport mbeturina inerte me auto te gjeneruara nga ndertimi ne vende te autorizuar deri 7.5 km, Perroi te Ura GCI, Palase;*
- 3. Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m?, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet Referuar kontrates;*
- a. Sistemim Asfaltim rruget e drejtorise se rajonit jugor Gjirokaster;*
- b. Germim dhe Mbushje per ndertimin e infrastruktures se perbashket ne objektin Green Coast 2;*
- c. Germim dhe Transport materiali te dale nga germimi deri ne nje distance 7 km ne Vilat 20-21-22-23-24-25-26-27-28 Zona G11 Green Coast 2, Palase;*
- 4. Mbushje me gur kave Sipas KVO “DEHA 2010” shpk duhet te kete pune IDENTIKE dhe jo te ngjashme me objektin e prokurimit. Lidhur me zerin e punimeve iMbushje me gur kavei DEHA 2010 shpk ka pune te ngjashme (mbushje me material dhe gur guroreje, mbushje me material nga germimet, shtresa te ndryshme rrugore, mbushje strukturore etj) te cilat i tejkalojne sasite dhe vleren e kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit Referuar kontrates;*
- a. Mbushje strukturale, Palase;*
- b. Germim dhe Mbushje per ndertimin e infrastruktures se perbashket ne objektin Green Coast 2*

; c. Mbushje me material te selektuar nga germimi Parkimi L, ne kantierin Green Coast 2, Palase; d. Germim mbushje i linjave KUSH dhe KUN per Infrastrukturen rrugore ne objektin Mgallery Hotel, projekti Green Coast e. “EPCPA01246 Ndertimi i rruges se aksesit dhe riveshje me asfaltobeton e rruges nga fshati Libofshe ne fshatin Agim, Fier” f. Sistemim Asfaltim rruget e drejtorise se rajonit jugor Gjirokaster”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën nr. 7 të dokumenteve të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.1 Operaret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratata;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikaten e perhershme te marrjes ne dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë siper marrje;
2. Leje per kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes ne dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve

ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

III.2.2. Në shtojcën nr. 5 të dokumenteve të tenderit, “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sipas Specifikimeve Teknike të ngarkuara në skedarët e SPE

III.2.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Deha 2010” SHPK dhe “Vianex” SHPK ndër të tjera ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë bashkimi i përkohëshëm i shoqërive BOE “Deha 2010” sh.p.k & “ViaNex” shpk (ish “Rroku GUEST” shpk), datë 22.09.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë “ViaNex” shpk (ish Rroku GUEST shpk) dhe shoqërisë “DEHA 2010” shpk, me objekt *“Bashkim i përkohëshëm i palëve për zbatimin e kontratës me emërtim objekti: “Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore në fshatin Corrush, Mallakastër”, ku në nenin 3 “pjesëmarrja”, përcaktohet se: “Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: shoqëria “Deha 2010” shpk 40 % (dyzet përqind), shoqëria “Vianex” shpk (ish Rroku GUEST shpk) 60 % (gjashtëdhjetë përqind)”*. Bashkëlidhur është përcaktuar edhe ndarja e punëve të BOE.
- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 01.10.2023 data e mbarimit të kontratës 30.10.2023. Objekti i kontratës: “Gërmim dhe transport materiali të dalë nga gërmimi deri në një distancë 7 km në vilat 20-21-22-23-24-25-26-27-28 zona G 11 green Coast 2, Palasë”. Operatori ekonomik Deha 2010 shpk. Autoriteti/enti kontraktor/investitori "Balfin Construction" SHPK (ish Mane TCI SHPK).
- Akt kolaudimi objekti “Gërmim dhe transport materiali të dalë nga gërmimi deri në një distancë 7 km në vilat 20-21-22-23-24-25-26-27-28 zona G 11 green Coast 2, Palasë”.
- Akt marrje e përhershme në dorëzim
- Situacion i punimeve “Gërmimi i vilave në nuklin G 11”, datë sit. Nëntor 2023
- Faturë nr. 67/2023, datë 20.11.2023
- Relacion shoqërues datë 01.10.2023, me nr. 1054 prot., datë 07.11.2023
- Kontratë sipërmarrje datë 01.10.2023 ndërmjet palëve Mane TCI SHPK dhe Deha 2010 shpk. Objekti: “Gërmim dhe transport materiali të dalë nga gërmimi deri në një distancë 7 km në vilat 20-21-22-23-24-25-26-27-28 zona G 11 green Coast 2, Palasë”
- Preventiv punimesh.

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 10.06.2024 - data e mbarimit të kontratës 30.06.2025. Objekti: “Gërmim, sistemim dhe transport mbeturina inerte me auto të gjeneruara nga ndërtimi në vende të autorizuar deri 7.5 km, përroi te Ura GCI, Palasë”.Autoriteti/enti/ivestitori Balfin Construction. Operatori ekonomik "Deha 2010"SHPK
- Akt marrje e përkohshme në dorëzim , datë 05.06.2025
- Akt kolaudimi datë 05.07.2024.
- Kontratë sipërmarrje datë 10.06.2024 ndërjet palëve Balfin Construction shpk dhe Deha 2010 shpk me objket: “Gërmim, sistemim dhe transport mbeturina inerte me auto të gjeneruara nga ndërtimi në vende të autorizuar deri 7.5 km, përroi te Ura GC1, Palasë”
- Situacion i punimeve për gërmimin e përroit, Ura GC1, data sit. I qershorit 2024
- Fatura tatimore nr. 49/2024, datë 12.06.2024

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 01.04.2024 - data e mbarimit 31.01.2025. Objekti: "Gërmim mbushje i linjave KUSH dhe KUN për infrastrukturën

- rrugore në objektin Mgallery Hotel, projekti Green Coast". Autoriteti/enti kontraktor/investitori Balfin Construction shpk, operatori ekonomik Deha 2010 shpk*
- Akt marrje e përkohshme në dorëzim, datë 07.02.2026
 - Akt kolaudimi datë 07.02.2025
 - Relacion shoqërues datë 01.04.2024 me nr. 747 prot., datë 05.07.2024
 - Kontratë sipërmarrje datë 01.04.2024 ndërmjet palëve Balfin construction dhe deha 2010 shpk me objekt: *"Gërmim mbushje I linjave KUSH dhe KUN për infrastrukturën rrugore në objektin Mgallery Hotel, projekti Green Coast*
 - Situacion i punimeve: *"Gërmim dhe transport materiali përballë Hotelit m gallery", sit. i janarit 2025*
 - Faturë tatimore nr. 6/2025, datë 07.02.2025
 - Faturë tatimore nr. 02/2025, datë 09.01.2025
-
- Formular vlerësimi - data 14.11.2022 - data e mbarimit të kontratës 30.06.2025. Obejkti: *"Gërmim dhe mbushje për ndërtimin e infrastrukturës së përbashkët në objektin Green Coast 2". Autoriteti/enti/investitori Balfin Construction shpk. Operatori ekonomik Deha 2010 shpk*
 - Akt marrje e përkohshme në dorëzim datë 05.07.2025
 - Akt kolaudimi datë 05.07.2025
 - Faturë tatimore nr. 47/2025, datë 05.07.2025
 - Faturë tatimore nr. 39/2025, datë 05.06.2025
 - Faturë tatimore nr. 18/2025, datë 08.04.2025
 - Faturë tatimore nr. 13/2025, datë 10.03.2025
 - Faturë tatimore nr. 05/2025, datë 07.02.2025
 - Faturë tatimore nr. 62/2024, datë 06.12.2024
 - Faturë tatimore nr. 43/2024, datë 07.11.2024
 - Faturë tatimore nr. 29/2024, datë 07.10.2024
 - Faturë tatimore nr. 12/2024, datë 07.09.2024
 - Faturë tatimore nr. 3/2024, datë 05.08.2024
 - Faturë tatimore nr. 42/2024, datë 01.06.2024
 - Faturë tatimore nr. 36/2024, datë 06.05.2024
 - Faturë tatimore nr. 28/2024, datë 02.04.2024
 - Faturë tatimore nr. 15/2024, datë 07.03.2024
 - Faturë tatimore nr. 7/2024, datë 06.02.2024
 - Faturë tatimore nr. 2/2024, datë 08.01.2024
 - Faturë tatimore nr. 69/2023, datë 06.12.2023
 - Faturë tatimore nr. 65/2023, datë 06.11.2023
 - Faturë tatimore nr. 47/2023, datë 04.08.2023
 - Faturë tatimore nr. 35/2023, datë 05.07.2023
 - Faturë tatimore nr. 33/2023, datë 06.06.2023
 - Faturë tatimore nr. 28/2023, datë 06.05.2023
 - Faturë tatimore nr. 22/2023, datë 05.04.2023
 - Faturë tatimore nr. 14/2023, datë 07.03.2023
 - Faturë tatimore nr. 4/2023, datë 06.02.2023

- Kontratë sipërmarrje datë 14.11.2022 lidhur ndërmjet Mane TCI dhe Deha 2010 shpk me objekt: *"Gërmim dhe mbushje për ndërtimin e infrastrukturës së përbashkët në objektin green coast 2"*
- Vendim nr. 28, datë 11.11.2022 i asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë Deha 2010 shpk
- Certifikatë regjistrimi
- Ekstarti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuara.

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 29.12.2022 - data e mbarimit 29.12.2023. Objekti: *"Punimet e betonit dhe hekurit për ndërtimin e mureve të infrastrukturës së Green Coast 2"*. Autoriteti/enti kontraktor/ investitori- Balfin Construction shpk- OE Deha 2010 shpk. Vlera sipas kontratës 88,748,960.00 lekë pa tvsh. vlera me tvsh 106,496,352.00 lekë me tvsh. Vlera e realizuar 13,956,029.60 lekë pa tvsh. vlera me tvsh 16,747,235.52
- Akt kolaudimi datë 15.01.2024
- Akt marrje e përkohshme në dorëzim datë 15.01.2024
- Faturë tatimore nr. 66/2023, datë 06.11.2023
- Faturë tatimore nr. 36/2023, datë 05.07.2023
- Faturë tatimore nr. 32/2023, datë 06.06.2023
- Faturë tatimore nr. 29/2023, datë 06.05.2023
- Faturë tatimore nr. 21/2023, datë 05.04.2023
- Faturë tatimore nr. 15/2023, datë 07.03.2023
- Relacion shoqërues me nr. 1728 prot., datë 29.12.2022
- Kontratë sipërmarrje, datë 13.12.2022 lidhur ndërmjet palëve Mane TCI shpk dhe Deha 2010 shpk
- Ofertë nga Deha 2010 shpk, datë 13.12.2022. Objekti: Punime betoni për mure pritës dhe mbajtës në Green Coast 2, palasë

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 05.12.2023, data e mbarimit të kontratës 04.02.2024. Autoriteti/enti kontraktor: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Operatori ekonomik - Rroku Guest shpk. Objekti: *"Ndërtim penela terthorë, argjinatura e Darragjani L = 177 m"*. Vlera sipas kontratës 27 944 895.60 lekë me tvsh. Vlera e realizuar 27 944 895.60 lekë me tvsh
- Kontratë nr. 574 prot., datë 04.12.2023 me objekt *"Ndërtim penela terthorë, argjinatura e Darragjani L = 177 m."*
- Certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve
- Akt kolaudimi datë 22.02.2024
- Situacion përfundimtar, objekti: *"Ndërtim penela terthore argjinatura e darragjati L=177m"*, periudha 14.12.2023-18.01.2024

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 19.05.2020- data e mbarimit të kontratës 03.06.2020 me objekt: *"Vepra e marrjes së ujit Mat-Lezhë"*, autoriteti kontraktor - Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. Operator ekonomik Rroku Guest shpk. Vlera sipas kontratës 3 100 825 lekë pa tvsh, vlera e realizuar 3 100 825 lekë pa tvsh

- Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve, datë 17.06.2020, objekti: "Vepra e marrjes së ujit Mat-Lezhë".
- Akt kolaudimi për punimet e kryera në objektin: "Vepra e marrjes së ujit Mat-Lezhë (punime emergjente)
- Situacion pjesor nr. 1, porositi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, objekti: Vepra e marrjes së ujit Mat-Lezhë (punime emergjente)
- Situacion pjesor nr. 2 dhe përfundimtare, porositi: drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, objekti: Vepra e marrjes së ujit Mat-Lezhë (punime emergjente)
- Situacion përfundimtar
- Kontratë me nr. 185/1 prot., datë 19.05.2020, objekti: "Vepra e marrjes së ujit Mat Lezhë (punime emergjente)
- Faturë tatimore datë 29.05.2020, nr. 90.
- Faturë tatimore datë 02.06.2020, nr. 95

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 15.11.2023- data e mbarimit të kontratës 31.05.2025. Objekti: "*Punime infrastrukturore në rrugën hyrëse të vilës 195, GCI, Palasë*", autoriteti/enti kontraktor/investitor: Balfin Construction shpk, operatori ekonomik: Deha 2010 shpk. Vlera sipas kontratës 531,395.00 lekë pa tvsh. 637,674.00 lekë me tvsh. Vlera e realizuar 3,957,364.88 lekë pa tvsh. Vlera me tvsh 4, 748,837.85 lekë me tvsh
- Akt marrje e përkohshme në dorëzim, datë 05.06.2025, objekti: "Punime infrastrukturore në rrugën hyrëse të vilës 195, GC1, Palasë".
- Akt kolaudimi datë 05.06.2025, objekti: "Punime infrastrukturore në rrugën hyrëse të vilës 195, GC1, Palasë".
- Relacion shoqërues me nr. 11741 prot., datë 11.12.2023
- Kontratë sipërmarrje me datë 11.11.2023, lidhur ndërmjet Mane TCI shpk dhe Deha 2010 shpk me objekt: "*Punime infrastrukturore në rrugën hyrëse të vilës 195, GCI, Palasë*"
- Preventiv punimesh
- Relacion shoqërues me nr. 425, datë 16.04.2024
- Relacion shoqërues me nr. 700, datë 20.06.2024
- Shtesë nr. 1 e kontratës së sipërmarrjes së datës 11.11.2023
- Preventiv punimesh
- Situacion i punimeve infrastrukturore, vila 195 GC1, data situacion i majit 2025
- Faturë tatimore nr. 40/2025, datë 05.06.2025
- Faturë tatimore nr. 17/2025, datë 08.04.2025
- Faturë tatimore nr. 9/2025, datë 05.03.2025
- Faturë tatimore nr. 37/2024, datë 31.10.2024
- Faturë tatimore nr. 31/2024, datë 05.04.2024
- Faturë tatimore nr. 1/2024, datë 05.01.2024

- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 30.10.2023 - data e mbarimit të kontratës 28.02.2025. Objekti: "*Mbushje strukturale*", autoriteti/enti kontraktor/investitori: Balfin Construction shpk. Operator ekonomik: Deha 2010 shpk. Vlera sipas kontratës: 41,082.40 euro pa tvsh, 49,298.88 euro me tvsh. Vlera e realizuar:

- 50,013.90 euro pa tvsh/5,049,670.34 lekë pa tvsh. Vlera me tvsh 60,016.67 euro me tvsh/6,059,604.40 lekë me tvsh
- Akt marrje e përkohshme në dorëzim
 - Akt kolaudimi datë 10.03.2025
 - Relacion shoqërues me nr. 1065 prot., datë 08.11.2023
 - Kontratë sipërmarrje lidhur ndërmjet mane TCI shpk dhe Deha 2010 shpk, datë 30.10.2023 me objekt: *"Mbushje strukturale"*
 - Aneks A- Preventivi me cmime
 - Situacion i punimeve mbushje strukturale me material të selektuar, hoteli Mgallery, Green coast, palasë. Data situacion i shkurtit 2025
 - Faturë tatimore nr. 14/2025, datë 10.03.2025
 - Faturë tatimore nr. 18/2024, datë 09.03.2024
 - Faturë tatimore nr. 06/2024, datë 02.02.2024
-
- Formular vlerësimi - data e fillimit të kontratës 01.02.2023 - data e mbarimit të kontratës 31.03.2025. Objekti i kontratës: *"Mbushje me material të selektuar nga gjermimi Parkimi L, në kantierin Green coast 2, Palasë"*. Autoriteti kontraktor: Balfin Construction shpk, operatori ekonomik Deha 2010 shpk. Vlera sipas kontratës 54,600.00 euro pa tvsh, 65,520.00 euro me tvsh. Vlera e realizuar 77,564.83 euro pa tvsh/ 8,050,683.23 lekë pa tvsh., vlera me tvsh 93,077.79 euro me tvsh/9,660,819.90 lekë me tvsh
 - Akt marrje e përkohshme në dorëzim, datë 07.04.2025
 - Akt kolaudimi , datë 07.04.2025
 - Relacion shoqërues me nr. 682 prot., datë 17.07.2023
 - Kontratë sipërmarrje lidhur ndërmjet Mane TCI shpk dhe Deha 2010 shpk, datë 01.02.2023, Objekti i kontratës: *"Mbushje me material të selektuar nga gjermimi Parkimi L, në kantierin Green coast 2, Palasë"*
 - Aneks kontrate
 - Preventiv punimesh
 - Situacion i punimeve parkim LGC2, data sit. I marsit 2005
 - Faturë tatimore nr. 16/2025, datë 07.04.2025
 - Faturë tatimore 46/2023, datë 03.08.2023
 - Faturë tatimore nr. 54/2023, datë 04.10.2023
 - Faturë tatimore nr. 58/2023, datë 04.10.2023
 - Faturë tatimore nr. 14/2024, datë 01.03.2024
-
- Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve, datë 25.06.2022. Objekti: *"Sistemim asfaltim Rruga "Darragjat", Dajç, Loti II*
 - Procesverbal i aktit të kolaudit, objekti: *"Sistemim asfaltim rruga "Darragjat", Dajç, Loti II*
 - Situacion perfundimtar, Objekti *"Sistemim asfaltim rruga Darragjat, dajç (faza 2 prog. 0 + 940 m-prog.1+315 m, L=375m)*
 - Faturë nr. 10, datë 26.04.2022.
 - Faturë nr. 14, datë 10.05.2022.

- Kontratë sipërmarrje punë publike me nr. 17300/8 prot., datë 21.12.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe "Rroku Guest" shpk, Objekti: "Sistemim asfaltim Rruga "Darragjat", Dajç Loti II
- Formular vlerësimi, data e fillimit të kontratës: 11.01.2022- data e mbarimit të kontratës-10.05.2022. Objekti i kontratës: "Sistemim asfaltim rruga Darragjat, Dajç-Loti II-të". AK Bashkia Shkodër, OE- Rroku Guest shpk. Vlera sipas kontratës: 7,897,422 lekë me tvsh, vlera 6,581,185 lekë pa tvsh. Vlera e realizuar: 7,896,000 lekë me tvsh. Vlera pa tvsh 6,580,000
- Kontratë nr. 513/4 prot., datë 15.11.2022. Objekti: "*Rehabilitim i argjinaturës Darragjat, segmenti PK.26, L=170m*", lidhur ndërmjet palëve "Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë" dhe BOE "Rroku Guest shpk & "Alb Tiefbau" shpk
- Akt- marrje e përkohshme në dorëzim, datë 04.03.2023. Objekti: "Loti 2 "Rehabilitimi i argjinaturës Darragjat, segmenti PK.26-33, L=170m".
- Akt kolaudimi, datë 04.03.2023. Autoriteti kontraktor - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Objekti: "Loti 2 "Rehabilitimi I argjinaturës darrgjat, segmenti PK. 26-33, L=170m"
- Situacion Përfundimtar
- Formular vlerësimi. Data e fillimit të kontratës-15.11.2022, data e mbarimit të kontratës - 30.12.2022. Objekti i kontratës Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë. OE- Rroku Guest shpk realizuar 80 % dhe Alb Tiefbau shpk realizuar 20 %. Objekti i kontratës: Loti 2 "rehabilitim i argjinaturës Darragjat, segmenti PK 26-33, L=170m". Vlera sipas kontratës 19,960,039.00 lekë me tvsh. Vlera pa tvsh 23,952,046.80 lekë pa tvsh. Vlera e realizuar- 19,959,260.00 lekë me tvsh. Vlera pa tvsh 23,951,112.00 lekë pa tvsh
- Kontratë Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Rroku Guest" shpk & "Alb Tiefbau" shpk, datë 30.09.2022
- Prokurë e posacme, datë 30.09.2022
- Faturë tatimore nr. 38, datë 15.12.2022
- Faturë tatimore nr. 44, datë 30.12.2022
- Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve. Objekti: "Rikonstruksion vazhdimi i rrugës Ajasem"
- Akt kolaudimi, objekti: "Rikonstruksion vazhdimi i rrugës Ajasem"
- Situacion Përfundimtar, Objekti: "Rikonstruksion vazhdimi i rrugës Ajasem"
- Faturë tatimore nr. 21, datë 30.12.2021.
- Faturë tatimore nr. 15, datë 13.05.2022.
- Kontratë sipërmarrje punë publike, nr. 14787/8 prot., datë 04.11.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Rroku Guest SHPK. Vlera e kontratës 11,991,363 lekë pa tvsh. Vlera me tvsh 14,389,635.60
- Formular vlerësimi. Data e fillimit të kontratës-14.12.2021, data e mbarimit të kontratës 13.05.2022. Autoritet kontraktor: Bashkia Shkodër, OE- Rroku Guest shpk. Objekti "*Rikonstruksion vazhdimi I rrugës Ajasem*". Vlera sipas kontratës 14,389,635.60 lekë me tvsh, 11,991,363.00 lekë pa tvsh. Vlera e realizuar 14,388,900.00 lekë më tvsh. Vlera pa tvsh 11,990,750.00 lekë pa tvsh.

- Formular vlerësimi- data e fillimit të punimeve 05.03.2025, data e mbarimit të punimeve 16.06.2025. Autoritet kontraktor - Autoriteti Rrugor Shqiptar, BOE "Deha 2010 shpk dhe Rroku Guest shpk", objekti: Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së rajonit jugor Gjirokastrë. Vlera e kontratës 99,999,507 lekë me tvsh. Vlera e realizuar 99,999,012.00 lekë me tvsh
- Akt kolaudimi, datë 02.07.2025. Objekti "Sistemim asfaltim rrugët e drejtorisë së Rajonit Rrugor gjirokastrë"
- Certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim, datë 02.07.2025.
- Kontratë nr. 990/3 prot., datë 05.03.2025 lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe BOE Deha 2010 shpk dhe Rroku Guest shpk. Objekti: "Sistemim asfaltim rrugët e rajonit jugor Gjirokastrë"
- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit Deha 2010 shpk
- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit Rroku Guest shpk
- Formular i ofertës Deha 2010 shpk
- Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit Deha 2010 shpk
- Kontratë bashkimi i përkohëshëm i shoqërive BOE "Deha 2010" shpk dhe "Rroku Guest" SHPK
- Prokurë e posaçme
- Formular i sigurimit të kontratës
- Formular i sigurimit të ofertës
- Situacion përfundimtar
- Situacion pjesor
- Faturë tatimore nr. 26/2025, datë 30.04.2025
- Faturë tatimore nr. 37/2025, datë 04.06.2025
- Faturë tatimore nr. 53/2025, datë 11.07.2025

- Formular vlerësimi, data e fillimit të kontratës 01.07.2021, data e mbarimit të kontratës 31.01.2022. autoriteti kontraktor: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, OE Ndertuesi 2014 shpk dhe Rroku Guest shpk. Objekti: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/Berdicë-Velipojë, U.Bunes (e re) Shirokë, krye Bushat-B.Jugë, D/Barbullush-Kukël 81.1 km". Vlera e kontratës 25,041,109 lekë pa tvsh. Vlera e realizuar 24,897,576.9 lekë pa tvsh
- Kontratë nr. 441/7 prot., datë 01.07.2021. Objekti: Loti III: "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/BerdicëVelipojë, U.Bunes (e re) Shirokë, krye Bushat-B.Jugë, D/Barbullush-Kukël 81.1 km
- Certifikatë pagese nr. 7 (përfundimtar)
- Situacion nr. 7 progresiv (përfundimtar)
- Certifikatë pagesë nr. 8
- Situacion nr. 8 progresiv
- Procesverbal i mbajtur në datë 31.01.2022 mbi kontrollin e punimeve të kryera në objektin "Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Q.Laç-Koman, H/Berdicë-Velipojë, U.Bunes (e re) Shirokë, krye Bushat-B.Jugë, D/Barbullush-Kukël 81.1 km"
- Faturë tatimore nr. 3/2021, datë 31.07.2021
- Faturë tatimore nr. 8/2021, datë 31.08.2021
- Faturë tatimore nr. 9/2021, datë 07.10.2021

- Faturë tatimore nr. 14/2021, datë 19.11.2021
- Faturë taimore nr. 20/2021, datë 13.12.2021
- Faturë tatimore nr. 23/2021, datë 31.12.2021
- Faturë tatimore nr. 1/2022, datë 31.01.2022
- Akt marrëveshje (kontratë bashkëpunimi) nr.repertori 2146, nr. Koleksioni 1147, datë 04.08.2020
- Prokurë e posaçme, nr. Repertori 2145, nr. Koleksioni 1146, datë 04.08.2020.

- Kontratë me nr. 344/1 prot., datë 26.07.2022, objekti: "*Mbrojtje nga lumi Kir*", lidhur ndërmjet palëve "Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë" dhe "Rroku Guest" shpk
- Akt marrje e përkohshme në dorëzim, datë 05.12.2022. Objekti: "Loti 18 "*Mbrojtje nga lumi Kir*"
- Akt kolaudimi datë 07.12.2022 për objektin "Loti 18, "*Mbrojtje nga lumi Kir*"
- Situacion përfundimtar
- Faturë tatimore nr. 32, datë 10.10.2022
- Faturë tatimore nr. 30, datë 26.09.2022
- Formular vlerësimi. Data e fillimit të kontratës 01.09.2022, data e mbarimit të kontratës 10.10.2022. Ak- Drejtoria e Ujitjes dhe kullimit Lezhë, OE: Rroku Guest shpk. Objekti: "*Mbrojtja nga lumi Kir*". Vlera sipas kontratës 8,159,639 lekë me tvsh. Vlera pa tvsh 6,799,699 lekë pa tvsh. Vlera e realizuar 8,157,596.40 lekë me tvsh. Vlera pa tvsh 6,797,997 lekë pa tvsh

- Formular vlerësimi – data e fillimit të kontratës 31.07.2024-data e mbarimit të kontratës 16.09.2024. Autoriteti/enti kontraktor Volalia Albanie, operatori ekonomik: Deha 2010 shpk. Objekti i kontratës: "*EPCPA01246 Ndërtim i rrugës së aksesit dhe riveshje me asfaltobeton e rrugës nga fshati Libofshë në fshatin Agim, Fier*". Vlera e realizuar 320,192.20 euro pa tvsh, 384,235.44 euro me tvsh.
- Akt kolaudimi datë 11.10.2024
- Akt marrje e përhershme në dorëzim, datë 11.10.2024
- Faturë tatimore nr. 11/2024, datë 28.08.2024
- Faturë tatimore nr. 17/2024, datë 16.09.2024
- Dokumentin e specifikimeve teknike të projektit
- Formular i sigurimit të ofertës

- Formular vlerësimi- data e fillimit të kontratës 09.10.2023, data e mbarimit të kontratës 08.04.2024. Autoriteti/enti kontraktor: Komanda e Forcës Tokësore (reparti ushtarak nr. 1001). BOE: Rroku Guest shpk 95 %, Deha 2010 shpk 5 %. Objekti: Sistemim i rrjetit rrugor dhe sheshit kryesor në repartin ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër". Vlera e realizuar 41 626 684.50 lekë pa tvsh. Vlera me TVSh 49 952 021.45 lekë tvsh.
- Certifikatë për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 3619/1 prot., datë 19.07.2024
- Situacion përfundimtar
- Akt kolaudimi, datë 30.05.2024
- Kontratë sipërmarrje me nr. 3638/2 prot., datë 07.08.2023 Sistemim i rrjetit rrugor dhe sheshit kryesor në Repartin Ushtarak nr. 1010, vau i Dejës, Shkodër.

- Faturë tatimore nr. 35, datë 16.12.2023
- Faturë tatimore nr. 5, datë 29.02.2024
- Faturë tatimore nr. 5, datë 26.06.2024

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Në nenin 92 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

III.2.8. Në nenin 39, pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron

kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.10. Nisur nga arsyeja e skualifikimit se: *“BOE “DEHA” sh.p.k & “VIANEX Shpk me NUIS L03425410B & K87921701H skualifikohet pasi nuk përmbush pikën 2.2 Kapaciteti teknik konkretisht pikën 2.3.1 Operoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, subjekti Deha Shpk Nuk e përmbushë këtë pikë pasi nuk ka realizuar punë të ngjashme për mbrojtje lumore”*, si dhe nga verifikimi i dokumentave të ngarkuara në SPE Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.1 të shtojcës nr. 7 të dokumentave të tenderit, BOE ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi.

Referuar kontratës “Kontratës së bashkimit të përkohëshëm të shoqërive BOE “Deha 2010” sh.p.k & “ViaNex” shpk (ish “Rroku GUEST” shpk), datë 22.09.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë “ViaNex” shpk (ish Rroku GUEST shpk) dhe shoqërisë “DEHA 2010” shpk, të ngarkuar në SPE nga BOE ankimues, Komisioni konstaton, se në kontratë përcaktohet si vijon: “[...] Neni 3 “pjesëmarrja”: “Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: shoqëria “Deha 2010” shpk 40 % (dzyet përqind), shoqëria “Vianex” shpk (ish Rroku GUEST shpk) 60 % (gjashtëdhjetë përqind)”. Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Deha 2010” SHPK merr përsipër të kryejë 40 % të punimeve, ndërsa operatori ekonomik “Vianex” SHPK merr përsipër të kryejë 60 % të punimeve. Bashkëlidhur kontratës kanë përcaktuar edhe ndarjen e punëve që do të kryejë secili prej antëtarëve të BOE ankimues, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë.

III.2.11 Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues me arsyetimin se: *“BOE “DEHA” sh.p.k & “VIANEX Shpk me NUIS L03425410B & K87921701H skualifikohet pasi nuk përmbush pikën 2.2 Kapaciteti teknik konkretisht pikën 2.3.1 Operoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, subjekti Deha Shpk Nuk e përmbushë këtë pikë pasi nuk ka realizuar punë të ngjashme për*

mbrojtje lumore”, Komisioni konstaton, se arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues lidhet me ngjashmërinë e objektit të punimeve të kontratave të realizuara nga operatori ekonomik “Deha 2010” shpk anëtar i BOE ankimues dhe jo me vlerën apo afatin e realizimit të tyre. Konkretisht nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, shtojcës nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, si dhe preventivit të punimeve të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar punimet që do të realizohen si vijon: “Mbushje me gur kave, Mbushje me zhavorr për rrugë aksesit, Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk në mjet, Transport dheu me auto deri 5.0 km. Referuar relacionit teknik projekti synon realizimin e mbrojtjes nga gërryerja e Lumit të Vjoses për mbrojtjen e tokave të shfrytëzuara, në fshatin Corrush, Bashkia Mallakaster. Projekti synon të identifikojë gjendjen, të propozoj nderhyrjet teknike dhe të gjitha masat e tjera të nevojshme që lidhen me kryerjen e punimeve të përmirësimit të situatës së deritanishme për sigurimin dhe garantimin e mbrojtjes nga gërryerjet në zonën e kerkuar. Objektivi kryesor është frenimi i gërryerjeve të metejshme të krahur të djathtë të lumit të Vjoses. Projekti përfshin mbrojtjen lumore gjatësore të tokave bujqësore.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP vëren, se bashkimi i operatorëve ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me punimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës BOE ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi.

Referuar dokumentacionit të sipërpërmendur, si dhe nisur nga arsyeja e skualifikimit se “*subjekti Deha Shpk Nuk e përmbushë këtë pikë pasi nuk ka realizuar punë të ngjashme për mbrojtje lumore*”, Komisioni konstaton, se referuar kontratave të dorëzuara nga BOE ankimues në SPE, rezulton se operatori ekonomik “Deha 2010” shpk ka kryer punime si vijon: “prishje shtresash ekzistuese, gërmim dheu me ekskavator me zinxhir, shtresë zhavorr lumi t=30 cm, shtresë stabilizant t=10 cm për bankina, shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makineri, shtresë asfaltbetoni me granil gure kave, transport dheu, gërmim dheu në seksion të hapur, për zbankime-terren me konsistencë mesatare ose të lartë shkëmbore, plus transportin e materialit mbetës në qendrat e autorizuar të grumbullimit, shtresa monolite betoni, transport dheu deri në 7 km, shtresë cakelli t=30 cm përhapur dhe ngjeshur me rrul, cilindrim kasonete me rrul (rrugë dhe trotuare), gërmim toke e fortë (shkëm i copëtuar) me ekskavator me zinxhir dhe shkarkim në mjet, gërmim kanal dhe transport jashtë kantierit 5-7 km, mbushje me material të selektuar nga gërmimet (0-20 mm), shtresë stabilizanti, mbushje me cakell të seleksionuar nga gërmimi i përhapur dhe ngjeshur me makineri me shtresa cdo 30 cm, mbushje me cakell e gur guroreje në trupin e rrugës, shtresë zhavorri lumi t=30 cm.

Referuar kontratave dhe faturave të dorëzuara në SPE, dhe konkretisht referuar punimeve të kryera nga operatori ekonomik “Deha 2010” SHPK si: “prishje shtresash ekzistuese, gërmim dheu me ekskavator me zinxhir, shtresë zhavorr lumi t=30 cm, shtresë stabilizant t=10 cm për bankina, shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makineri, shtresë asfaltbetoni me granil gure kave, transport dheu, gërmim dheu në seksion të hapur, për zbankime-terren me konsistencë mesatare ose të lartë shkëmbore, plus transportin e materialit mbetës në qendrat e autorizuar të grumbullimit, shtresa monolite betoni, transport dheu deri në 7 km, shtresë cakelli t=30 cm përhapur dhe ngjeshur me rrul, cilindrim kasonete me rrul (rrugë dhe trotuare),

gërmim toke e fortë (shkëm i copëtuar) me eskavator me zinxhir dhe shkarkim në mjet, gërmim kanali dhe transport jashtë kantierit 5-7 km, mbushje me material të selektuar nga gërmimet (0-20 mm), shtresë stabilizanti, mbushje me cakëll të seleksionuar nga gërmimi i përhapur dhe ngjeshur me makineri me shtresa cdo 30 cm, mbushje me cakëll e gur gurorë në trupin e rrugës, si dhe preventivit dhe relacionit teknik të procedurës së prokurimit objekte ankmi, Komisioni gjykon se, kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik “Deha 2010” SHPK kanë si objekt: gërmime dhe transport inertesh; mbushje strukturore dhe mbushje me materiale të selektuara; punime infrastrukturore rrugore (rrugë private, asfaltim); punime betoni dhe armature për mure infrastrukturore; punime për infrastrukturë të përgjithshme në projekte private, por në asnjë prej kontratave: nuk përmendet shtrat lumi; nuk përmenden rrjedhje ujore; nuk përmenden argjinatura, gabione apo vepra hidraulike; nuk përmendet funksion mbrojtjeje lumore. Për rrjedhojë, kontratat e paraqitura nuk përbëjnë punë të ngjashme në fushën e mbrojtjes lumore, në kuptim të pikës 2.3.1 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit. Sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik, ngjashmëria e punëve vlerësohet sipas funksionit teknik dhe objektit. Edhe në vlerësim tërësor të kontratave të paraqitura: nuk ekziston një grup kontratash homogjene në mbrojtje lumore; nuk provohet realizimi i punëve të ngjashme sipas natyrës teknike; për rrjedhojë, nuk përmbushet kriteri i veçantë i kualifikimit, pika 2.3.1 të shtojcës nr. 7, të dokumentave të tenderit përse i përket ngjashmërisë së punëve të kryera. Krijimi artificial i një ngjashmërie nga kontrata me natyra të ndryshme do të binte ndesh me, parimin e barazisë së trajtimit, parimin e transparencës, sigurinë juridike të procedurës.

Operatori ekonomik “DEHA 2010” sh.p.k. anëtar i BOE “Deha 2010” SHPK dhe “Rroku Guest” SHPK nuk ka provuar përvojë të mëparshme në punë të ngjashme në fushën e mbrojtjes lumore.

Sa më sipër, KPP gjykon, se referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat dhe faturat e mësipërme të paraqitura nga operatori ekonomik “Deha 2010” SHPK pjesë e BOE “Deha 2010” SHPK dhe “ViaNex” SHPK nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1. të kapacitetit teknik, lidhur me ngjashmërinë e punëve të kryera, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit të KVO-së është e drejtë.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimes nuk qëndron.

III.3. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Ardmir” SHPK dhe “Meteo” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes, ku

një prej të cilave është edhe paraqitja e ankesës sipas formularit përkatës, në mbështetje të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.3.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ rezulton se në datë 28.10.2025 bashkimi i operatorëve ekonomik “Ardmir” SHPK dhe “Meteo” SHPK ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ankesën me nr. ankimi elektronik A/2025/6015 dhe me nr. 3053/2025 Protokolli, datë 28.10.2025.

Nga verifikimi i ankesës së dorëzuar në Sistemin e Ankesave Elektronike, Komisioni konstaton, se ajo nuk është bërë sipas formularit përkatës të dokumentave standarte të tenderit të miratuara me vendim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”*, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua më kërkesën për informacion autoritetit kontraktor, Bashkisë Mallakastër me shkresën me nr. 3053/3 prot., datë 03.12.2025 me kërkesën për informacion si vijon: *“Në pikën 2 dhe 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së dorëzuar nga BOE “ARDMIR” SHPK & “METEO” SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit nuk ka paraqitur formularin e ankesës sipas shtojcës “Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, të dokumentave standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Referuar nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjvënësi i ka dhënë operatorit ekonomik mundësinë procedurale të korrigjimit të të metave nëse formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, brenda dy ditëve nga njoftimi i autoritetit kontraktor. Referuar bazës ligjore të sipërcituar është autoriteti kontraktor i cili duhet të kryejë veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimes për ndreqjen e të metave të ankesës. Sa më sipër, e qëllim vijimin e gjykimit të ankesës kërkojmë nga ana juaj informacion nëse keni kryer veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimes për ndreqjen e të metave të ankesës.”

Me shkresën me nr. 4086/24 prot., datë 05.12.2025 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj me nr. 3053/3 prot., datë 03.12.2025 “Kërkesë për informacion”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3053/4 prot., datë 09.12.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër ka informuar si vijon: “[..] Nga shqyrtimi i ankesës nga ana jonë nuk është konstatuar që operatori ekonomik nuk e ka paraqitur ankesën sipas shtojcës “Formulari i ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, pasi ankesa e kryer nga operatori ekonomik përmbushte të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me çështjen objekt ankimi (palët/objekti i ankimit/rrethanat e ankimit/shkaqet e ankimit/si dhe kryerja e pagesës së vlerës së përcaktuar). Përsa më sipër nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës është vijuar me trajtimin e ankesës në bazë të dokumentacionit të paraqitur në sistem nga BOE “Ardmir” shpk dhe “Meteo” shpk dhe ngarkimin e vendimit në sistemin elektronik të ankesave [..]”.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ka paraqitur ankesën nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ashtu sic përcaktohet në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por ky i fundit nuk ka paraqitur formularin e ankesës sipas shtojcës “Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, të dokumentave standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: “2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Nga ana tjetër në pikën 3 të po këtij neni parashikohet shprehimisht se: “3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar është autoriteti kontraktor i cili duhet të kryejë veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës.

Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 4086/24 prot., datë 05.12.2025, rezulton që autoriteti kontraktor nuk ka kryer veprime procedurale për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues për ndreqjen e të metave të ankesës. Në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndreqjen e të metave të ankesës në zbatim të pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, si dhe referuar ankesës së paraqitur në SAE nga BOE ankimues Komisioni konstaton, se në ankesën e dorëzuar evidentohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, pagesa e tarifës së ankesës, rrethanat e çështjes, shkaqet e ankimit, ankesës. Si rrjedhojë në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndreqjen e të metave të ankesës përsa i përket formularit të ankesës, në kushtet kur ankesa është dorëzuar nëpërmjet SAE dhe evidentohen të gjitha të dhënat e përcaktuara në nenin 111 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin

publik”, i ndryshuar, Komisioni gjykon se ankesa e dorëzuar pranë KPP-së plotëson kushtin formal lidhur me formularin e paraqitjes së ankesës.

III.3.2 Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Ardmir” shpk dhe “Meteo” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “[...] Në fakt, siç rezulton nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem (i përfshirë në dosjen e ofertës sonë), Shtojca nr. 8 është dorëzuar e plotësuar dhe nënshkruar nga Administratori Renato Aliaj, përfshirë të gjitha pjesët A, B, C dhe D të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Në faqen përfundimtare të formularit (f.18), megjithëse nga përmbajtja rezulton që të ketë karakter fakultativ, pasi është evidentuar në përmbajtje të kësaj Rubrike “Nëse kërkohet,” është qartësisht e përfshirë deklarata e kërkuar në pikën D që ka këtë përmbajtje: “Deklaroj nën përgjegjësinë time se në këtë procedurë prokurimi nuk jam i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohem vetëm për realizimin e këtij objekti.” Në këtë rubrikë nuk janë specifikuar kriteret konkrete teknike sikurse janë deklaruar nga Operatorët Ekonomikë, por ekstra janë paraqitur deklarata të vecanta që konfirmojnë vullnetin e BOE që në rast se është e nevojshme kapacitetet teknike, konkretisht Drejtuesi Teknik për objektin përkatës, z. Hekuran Sheshi dhe makineritë dhe pajisjet e deklaruar, do të jenë të angazhuar vetëm në këtë kontratë. Deklaratat janë nënshkruar, vulosur dhe datojnë më 23.09.2025, pra para afatit të dorëzimit të ofertave, duke provuar pa mëdyshje se dokumenti ekziston dhe është i vlefshëm.

[...] Ky formulim (“Nëse kërkohet”) tregon se detyrueshmëria e kësaj deklarate nuk është absolute, por kushtëzohet nga përcaktimi i saj shprehimisht në dokumentet e tenderit (DST) si një kriter specifik i kualifikimit. Në rastin konkret, pas shqyrtimit të DST-së së procedurës me objekt “Mbrotjtja lumore”, rezulton se në asnjë pjesë të saj autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar ndonjë kërkesë të veçantë për paraqitjen e kësaj deklarate apo për angazhimin ekskluziv të stafit teknik. Në mungesë të një përcaktimi të tillë, rubrika D e Shtojcës 8 nuk mund të konsiderohet kriter detyrues për kualifikim, por vetëm një element formal standard i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, i parashikuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 26 të VKM nr. 285/2021. Në rastin konkret, të dy operatorët ekonomikë, “ARDMIR” sh.p.k. dhe “METEO” sh.p.k., kanë dorëzuar deklarata të veçanta të nënshkruara, me përmbajtje identike me tekstin e rubrikës D, ku konfirmohet se kapacitetet teknike të deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera publike dhe se do të përdoren ekskluzivisht për realizimin e objektit të prokurimit. Këto deklarata përbëjnë prova të barasvlefshme dhe të vlefshme për përmbushjen e qëllimit të rubrikës D dhe garantojnë në substancë të njëjtën siguri juridike që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Në këtë mënyrë, mosplotësimi i rubrikës D në vetë formularin standard, kur ekziston një deklaratë e veçantë ekuivalente, nuk mund të konsiderohet “mospranim” apo “devijim material” në kuptim të nenit 82 pika 2 të VKM nr. 285/2021 dhe nenit 92 pika 4 të Ligjit nr. 162/2020. Përkundrazi, është një mangësi formale, e cila, në përputhje me nenin 26 pika 7 dhe nenin 82 pika 3 të VKM-së, duhej të sqarohej me shkrim nga operatori ekonomik, përpara se të merrej vendimi për skualifikim. Në vijim të kësaj logjike, skualifikimi për mungesë të plotësimit të rubrikës D, pa marrë parasysh deklaratat e veçanta të dorëzuara, është joproporcional dhe në kundërshtim me parimin e konkurrencës së ndershme, të parashikuar në nenin 6 të Ligjit nr. 162/2020, si dhe me nenin 39 pika 4 dhe 8 të

VKM nr. 285/2021, të cilat kërkojnë që kriteret e kualifikimit të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin dhe aftësinë zbatuese të kontratës.

Skualifikimi i BOE “ARDMIR” shpk & “METEO” shpk, me arsyen “mosplotësim i deklaratës mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”, është i pambështetur ligjërisht, sepse nuk bazohet në asnjë shkak të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020; është i paligjshëm proceduralisht, sepse është marrë pa kërkuar sqarim paraprak, në kundërshtim me nenet 26/7 dhe 82 të VKM 285; i pajustificuar materialisht, sepse ekziston deklaratë e barasvlefshme që përmbush të njëjtin kriter; si dhe joproporcional, pasi penalizon formën, jo përmbajtjen, duke cënuar konkurrencën.

[...] Vendimi i skualifikimit është rrjedhojë e një konstatimi materialisht të pasaktë të gjendjes faktike. Nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara rezulton se Shtojca nr. 8 përmban katër pjesë (A, B, C dhe D) të cilat janë të gjitha të plotësuara. Në faqen përfundimtare (faqja 18), pika D përfshin tekstin standard të kërkuar nga Dokumentet Standarde të Tenderit: “Deklaroj nën përgjegjësinë time se në këtë procedurë prokurimi nuk jam i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohem vetëm për realizimin e këtij objekti.” Kjo deklaratë është konfirmuar lidhur me kapacitetet teknike të deklaruara në akte të vecanta nga Operatorët Ekonomikë. Ndërkohë që si Formulari i Vetëdeklarimit edhe deklaratat janë të nënshkruara rregullisht nga subjektet përkatës. Kjo do të thotë se vendimi i Autoritetit Kontraktor është marrë mbi një supozim të gabuar faktik, pasi dokumenti ekziston dhe është i vlefshëm. Vendimmarrja mbi bazën e fakteve të pasakta përbën shkelje të Ligjit nr. 162/2020, i cili kërkon që kualifikimi apo skualifikimi i Operatorëve Ekonomikë të bazohet në verifikim të plotë të dokumentacionit të paraqitur [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.3 Në shtojcën nr. 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në pikën 1/a autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 8.**

III.3.4. Në shtojcën nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomiknuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

¹Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë

është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga

Përgjigje

Po [] Jo []

Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
--	--

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 2. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 3. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

III.3.5 Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur BOE “Ardmir” shpk dhe “Meteo” shpk ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Ardmir” shpk të nënshkruar dhe vulosur ku në pjesën III, pika D. “Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera” ka deklaruar si vijon: *“Në cilësinë e operatorit ekonomik, Ardmir deklaroj nën përgjegjësinë time se: i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.*
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Meteo” shpk të nënshkruar dhe vulosur ku në pjesën III, pika D. “Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera” ka deklaruar si vijon: *“Në cilësinë e operatorit ekonomik “Meteo” shpk deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetete/pajisjet/makinertë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me*

legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti”.

III.3.6. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të

zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji....”

III.3.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e

originës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.9. Në rastin konkret nisur nga arsyetja e skualifikimit të BOE “Ardmir” SHPK dhe “Meteo” SHPK me arsyetimin se: *“BOE“ARDMIR” Shpk & Meteo Shpk me NUIS K82509006P & L26310801C skualifikohen pasi nuk përmbushin pikën 1 KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT konkretisht shtojcën nr 8 pika D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera, operatorët ekonomik nuk kanë plotësuar këtë deklaratë”,* si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga BOE ankimues Komisioni konstaton, se BOE ka ngarkuar në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Ardmir” shpk të nënshkruar dhe vulosur, ku në pjesën III, pika D. *“Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”* ka deklaruar si vijon: *“Në cilësinë e operatorit ekonomik, Ardmir deklaroj nën përgjegjësinë time se: i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti”.*

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Meteo” shpk të nënshkruar dhe vulosur ku në pjesën III pika D. *“Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”* ka deklaruar si vijon: *“Në cilësinë e operatorit ekonomik “Meteo” shpk deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetete/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të*

kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti". Referuar pjesës III, pika D dhe deklaratës së sipërcituar të bërë nga operatori ekonomik "Meteo" SHPK, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka deklaruar në mënyrë të plotë që stafi teknik, mjetet dhe pajisjet nuk janë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër. Edhe në kushtet kur operatori ekonomik nuk ka listuar emrat e stafit apo makinerive, Komisioni gjykon, se stafi dhe makineritë janë të listuara në pjesën III, pika C "Deklaratë për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate", të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Në këto kushte deklarata mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera e bërë nga operatori ekonomik "Meteo" Shpk anëtar i BOE ankimes përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor.

Lidhur me Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit" të dorëzuar në SPE, të plotësuar nga operatori ekonomik "Ardmir" shpk anëtar i BOE "Ardmir" shpk dhe "Meteo" shpk operatori ekonomik "Ardmir" SHPK ka deklaruar në pjesën III, pika D "Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera" si vijon: *"Në cilësinë e operatorit ekonomik, Ardmir deklaroj nën përgjegjësinë time se: i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti"*.

Nga verifikimi i kryer Komisioni konstaton, se operatori ekonomik "Ardmir" shpk nëpërmjet deklarimit të bërë ka dhënë indicie që stafi dhe makineritë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, duke plotësuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, pika D "Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik "Ardmir" shpk ka plotësuar shtojcën 8, pjesa III, pika D "Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera", të dokumentave të tenderit, duke dhënë një indice për plotësimin e kësaj deklarate. Nëse autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me deklaratën e operatorit ekonomik "Ardmir" shpk mund ti kishte kërkuar sqarime. Akoma më tej nisur nga arsyeja e skualifikimit, Komisioni konstaton, se bazuar në materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ vihet re, se autoriteti kontraktor në asnjë koment nuk e ka shfaqur të nevojshme të kryejë verifikime apo të kërkojë sqarime nga operatori ekonomik në lidhje me deklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Akoma më tej referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton, se bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes ka plotësuar deklarata të veçanta të nënshkruara, me përmbajtje identike me tekstin e rubrikës D, ku konfirmohet se kapacitetet teknike të deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera publike dhe se do të përdoren ekskluzivisht për realizimin e objektit të prokurimit, duke dhënë një indice që plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes në momentin e paraqitjes në SPE të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe plotësimin e shtojcës nr. 8 pjesa III, pika D "Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera" ka përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor për këtë fazë të

procedurës në përputhje me legjislacion sektorial në fuqi për prokurimin publik. Akoma më tej Komisioni thekson se referuar nenit 124 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë..

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ISEC” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-60311-09-04-2025, me objekt “Mbrotjtje Lumore Gjatesore E Tokave Bujqesore Ne Fshatin Corrush, Mallakaster” me fond limit 55,214,284.00 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmbydhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakaster.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Deha 2010” shpk dhe “ViaNex” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Ardmir” SHPK dhe “Meteo” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedureës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare nga BOE “Deha 2010” shpk dhe “ViaNex” SHPK.

7. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ISEC” SHPK.
 8. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Ardmir” SHPK dhe “Meteo” SHPK.
 9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

